REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.18.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Udhëheqësi i ekipit Agron Fetiu, dhe Anëtaret e ekipit Arta Birinxhiku dhe Burbuqe Idrizi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 10

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 16

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 28

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 29

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 32


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në memon e planifikimit të auditimit, e datës 12/10/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

<u>Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes</u>

Pasqyrat financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si theksim të çështje ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës gabimisht kishte planifikuar dhe paguar mallra dhe shërbime në vlerë 157,589€ nga kategoria e investimeve kapitale. Si dhe pasuritë nën vlerën 1,000€ ishin të nënvelrësuara për 181,398€. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka planifikuar dhe paguar gabimisht një pjesë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në kategorinë e investimeve kapitale.	Kryesuesi duhet të sigurojë që me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje të siguroj që të gjitha shpenzimet janë regjistruar në kategorinë ekonomike përkatëse (shih çështjen nr. 5).
Raporti i inventarizimit i cili shrytëzohej për prezantimin e pasurive mbi vlerën 1,000€ në pasqyrat financiare (në mungesë të evidencave të rregullta) nuk ishte i plotë. Si rezultat pasuritë jo-financiare ishin të nënvlerësuara.	Kryesuesi duhet të ndërmarrë veprimet e duhura që sistemi e-pasuria të futet sa më shpejtë në përdorim. Në rast nevoje, zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e këtij sisitemi (shih çështjen nr. 10).
Rekomandimet e dhëna në vitin paraprak nga auditimi i jashtëm dhe i brendshëm nuk po adresohen në nivel të kënaqshëm në raport me kërkesat për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.	Kryesuesi duhet ta zbatojë një proces të rishikimit për të siguruar që rekomandimet e vitit paraprak të dhëna nga auditimi i jashtëm dhe i brendshëm të adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/proceset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet nr. 1 dhe 4).
Këshilli Gjyqësor i Kosovës për vitin 2015 nuk kishte dorëzuar raportin e vetvlerësimit si dhe nuk e kishte krijuar një regjistër të rreziqeve që do të identifikonte pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave.	Kryesuesi duhet sigurojë që është plotësuar pyetsori i vetvlerësimit për të siguruar informacione të plota për Ministrin e Financave, si dhe të sigurojë se është bërë një regjistër i rreziqeve të mundshme, përshirë edhe veprimet për menaxhimin e tyre (shih çështjet nr. 2 dhe 3).

Përgjigja e Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës – auditimi 2015

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuara në to. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacioneve në kuadër të tyre. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PVF-të e KGJK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të PVF-ve si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, PVF-të paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të KGJK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Bazë për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në përgjegjësitë e auditorit në pjesën e raportit tonë për auditimin e PVF-ve. Ne jemi të pavarur nga KGJK, në përputhje me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e PVF-ve në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike tonat në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë.

Theksimi i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- KGJK ka planifikuar gabimisht një pjesë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në kategorinë e investimeve kapitale. Ata nuk kanë marrë masa për transferimin e tyre në kategorinë përkatëse, mirëpo kanë procesuar dhe evidentuar blerjen në kategorinë e investimeve kapitale. Vlera totale e keq klasifikimit ishte 157,589€; dhe
- Në mungesë të evidencave për menaxhimin e pasurisë me vlerë nën 1,000€, KGJK për raportimin e tyre në PVF, kishte përdorë të dhënat e nxjerra nga raportet e inventarizimit që ishin bërë në fund të vitit. Mirëpo për shkak se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk e kishte kryer inventarizimin me kohë, raporti përmbledhës i inventarizimit nuk ishte i kompletuar. Si rezultat i kësaj pasuritë jo-financiare të prezantuara në PVF ishin të nënvlerësuara për 181,389€.

Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe PVF-të

Drejtori i Përgjithshëm i KGJK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF-ve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF-ve pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i KGJK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit të Pavarur.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PVF-ve

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PVF-të në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse PVF-të nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PVF-të në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre PVF-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në PVF. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu

edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PVF, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e PVF-ve nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të PVF-ve.

1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

Në memorandumin e planifikimit të auditimit, të datës 12 dhjetor 2015, ne nuk kemi identifikuar rreziqe domethënëse për PVF-të. Mirëpo, rishikimet tona gjatë fazës finale të auditimit kanë identifikuar dy rreziqe të cilat nuk do të ndikojnë në kualifikimin e opinionit, mirëpo do të rezultojnë në theksim të çështjeve:

Njëri ka të bëjë me keq klasifikimin e shpenzimeve në vlerë 157,589€ (realizimin e shpenzimeve në kategori jo adekuate). Planifikimi dhe realizimi i tyre gabimisht ishte bërë në kategorinë e investimeve kapitale derisa për nga natyra i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa tjetri me shpalosjen e pasurive jo financiare nën 1,000€ në PVF, përkatësisht me nënvlerësimin e tyre për 181,389€.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

KGJK, kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Kërkesat e rregullës 01/2013/MF- për shpenzimin e Parasë;
- Kërkesat e rregullës MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Kërkesat e rregullës MF nr-02/2013 për raportimin e obligimeve te papaguara; dhe
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në draft PVF-të ishin të nevojshme disa korrigjime në pjesën e shënimeve rreth PVF-ve. Për të siguruar raportimin e duhur ne sugjeruam korrigjimet si në vijim:

- *Te pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme* - Kthimi i depozitave nga fondi i mirëbesimit ishte nënvlerësuar për 1,131,000€;
- *Te pasqyra e ekzekutimit të buxhetit* - Te dalja e parasë së gatshme në llogarinë e thesarit, vlera e prezantuar e depozitave në fondin e mirëbesimit ishte nënvlerësuar për 1,131,000€; dhe
- *Pasuritë jo financiare si pjesë e shpalosjeve në PVF*, vlera e pasurive nën vlerën 1,000 ishte nënvlerësuar për 181,389€.

Pas sugjerimeve tona KGJK ka korrigjuar PVF-të e saj dhe versioni final (pasqyra e pranimeve dhe pagesave si dhe pasqyra e realizimit të buxhetit) ishte prezantuar në përputhje me Rregullorën MF- nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Derisa shpalosja e pasurive nuk ishte korrigjuar për shkak se ishte identifikuar pas datës 31 mars 2016, pas kësaj date korrigjimet në PVF nuk pranohen nga MF. Kjo çështje është shpalosur te nënkapitulli kapitulli 3.7.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Ato janë përmbushur në tërësi nga KGJK-ja.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KGJK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të KGJK-së ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohet edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Institucionit. Një pjesë e rekomandimeve nga auditimi i jashtëm nuk ishin implementuar. Më tutje, rekomandimet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) nuk janë trajtuar sa duhet nga menaxhmenti. Vetëm 40% e tyre janë implementuar.

KGJK nuk e ka dorëzuar pyetësorin e vetvlerësimit, për vitin 2015, në NjQH-MF. Mos dorëzimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit në MF paraqet anashkalim të Rregullores së Thesarit 01/2010, dhe mungesë të informacionit për Ministrin e Financave rreth funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Dobësi kishte edhe në identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, për të identifikuar pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të KGJK-së ka rezultuar me shtatë rekomandime kryesore. KGJK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, një rekomandim është implementuar, tri janë adresuar pjesërisht, ndërsa tri nuk janë adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 – Nivel i ulët i implementimit të rekomandimeve – Prioritet i lartë

E gjetura

KGJK ka hartuar planin për implementimin e rekomandimeve, por nuk ka marrë hapa konkrete për të monitoruar mënyrën e implementimit të tyre.

Rekomandimet e pa implementuara ndërlidhën: me nxjerrjen e urdhërblerjes pas pranimit të faturës, vonesat në zotimin e mjeteve, vonesat në procesimin e pagesave, keq klasifikimet, si dhe raportimin jo të plotë të pasurive.

Rreziku

Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare dhe të cilat nuk janë adresuar, kanë rezultuar në:

- Dobësitë në procesimin e pagesave si dhe në raportimin e tyre; dhe
- Mungesë të informatave për pasurinë në dispozicion si dhe krijimi i mundësive për keqpërdorimin e tyre.

Rekomandimi 1

Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për Organizatat Buxhetore (OE) për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për KGJK-në të cilat së bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Lista kontrolluese e vetvlerësimit nuk është dorëzuar në MF - Prioritet i lartë

E gjetura

Bazuar në Rregullën e Thesarit 01/2010- për MFK-në, të gjitha OB-të janë të obliguara që në NJQH-MF ta dorëzojnë listën kontrolluese të vetvlerësimit pas çdo viti kalendarik.

Ministri i Financave në një shkresë drejtuar të gjitha OB-ve ka kërkuar që të gjitha OB-të t'i plotësojnë dhe dorëzojnë pyetësorët e vetvlerësimit në NJQH-MF deri më 29 shkurt 2016.

Edhe përkundër kërkesës së rregullorës dhe shkresës së Ministrit të Financave, KGJK nuk e ka dorëzuar pyetësorin e vetvlerësimit në NjQH-MF për vitin 2015.

Rreziku

Mos dorëzimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit në MF paraqet anashkalim të Rregullores së Thesarit 01/2010, dhe mungesë të informacionit për Ministrin e Financave rreth funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Rekomandimi 2

Kryesuesi i KGJK-së duhet sigurojë që janë përmbushur kërkesat ligjore (respektimi i Rregullave të Thesarit) për të ofruar informacione të plota për Ministrin e Financave lidhur me funksionimin e sistemit të MFK-së. Pas plotësimit të listës kontrolluese të vetvlerësimit duhet të aplikohet një mekanizëm për të rishikuar dhe për të konfirmuar saktësinë e saj si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për të gjitha të dhënat e prezantuara.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KGJK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në komponentën e 2-të të pyetësorit të vetvlerësimit kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik. Po ashtu, dispozitat e LMFPP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçe të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

KGJK ka hartuar strategjinë 2014-2019 në të cilën ishin paraparë pesë shtyllat strategjike që paraqesin gjerësisht, aspiratat e komunitetit gjyqësor. Brenda secilës shtyllë janë paraparë qëllimet specifike për jetësimin e aspiratave. Për secilin qëllim janë përcaktuar objektiva strategjike konkrete, për t'u siguruar realizimin e tyre. Ndërsa secila objektivë strategjike përmbante një pasqyrë të përgjithshme të planit të veprimit për ta realizuar atë.

Në gjithë këtë proces mungonin aktivitetet për menaxhimin e rrezikut.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

E gjetura Menaxhmenti i KGJK-së nuk ka aprovuar/aplikuar ndonjë procedurë formale për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve operacionale në nivel të organizatës e në veçanti në këtë fazë të procesit të decentralizimit.

Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata.

Rreziku Proceset e dobëta për identifikimin e rreziqeve reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda organizatës buxhetore, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

KGJK, ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të KGJK-së ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat si dhe analiza të kompletuara rreth realizimit të buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë - Drejtori i NJAB-së dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i cili reflekton rreziqet financiare dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të NJAB-së duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

NJAB ka hartuar planin strategjik dhe vjetor ku janë paraparë nëntë auditime gjatë vitit 2015, duke u fokusuar në fushat të cilat paraqesin rrezik më të lartë. Kjo njësi ka përmbushur në tërësi planifikimin duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Komiteti i Auditimit (KA) ka mbajtur tri takime të rregullta në të cilat janë shqyrtuar rekomandimet e Auditimit të Brendshëm.

Çështja 4 – Nivel i ulët i adresimit të rekomandimeve të NJAB-së – Prioritet i lartë

E gjetura

Udhëzimi Administrativ nr. 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik kërkon që i njëjti të mban së paku katër takime në vit. KA në kuadër të KGJK-së kishte mbajtur vetëm tri takime në të cilat janë analizuar dhe shqyrtuar rekomandimet e NJAB-së.

Raportet e auditimit të brendshëm nuk ishin trajtuar në nivelin e duhur nga menaxhmenti. Niveli i implementimit të rekomandimeve të dhëna ishte i ulët. Nga gjithsej 25 rekomandimet e dhëna, vetëm 10 prej tyre ishin implementuar plotësisht.

Rreziku

Mos adresimi i rekomandimeve të AB-së dhe trajtimi jo i duhur i raporteve të tyre (KA dhe Menaxhmenti), do të ketë ndikim negativ në funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme si dhe rritë rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të përsëriten në vazhdimësi.

Rekomandimi 4

Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj një bashkëpunim të ngushtë në mes të menaxhmentit dhe NJAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe të ndërmerr veprime shtesë që rekomandimet e kësaj njësie të gjejnë zbatim në praktikë. Më tej, KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, të mbaj takime të rregullta dhe të mbaj menaxhmentin më përgjegjës për implementimin e rekomandimeve.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

KGJK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces relativisht të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Realizimi i buxhetit në raport me vitin 2014 është përmirësuar për 7%, duke arritur në 98%, megjithëse këtë përqindje e kishin ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund të vitit. Të hyrat janë më të ulëta për 13% në raport më vitin 2014 ,mirëpo kjo ishte rezultat i rënies së të hyrave nga gjobat e trafikut. Realizimi i procedurave të prokurimit publik ishte në përputhje me rregullat e përcaktuara për prokurimin publik me përjashtim të dobësive në procesimin e pagesave (vonesat në zotimin e mjeteve, urdhërblerjet si dhe vonesat në realizimin e pagesave).

Megjithatë, një numër i dobësive duhet të përmirësohet edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të KGJK-së. Përkundër rekomandimeve të dhëna në raportet e viteve paraprake, edhe në vitin 2015 kishte pagesa për mallra dhe shërbime nga kategoria e investimeve kapitale, megjithëse vlera e keq klasifikimit ishte nën vlerën materiale. Sistemi e-pasuria nuk ishte në funksion andaj mungonin evidencat për pasuritë nën vlerën 1,000€. Për prezantimin e të dhënave në PVF, shfrytëzohen të dhënat nga procesi i inventarizimit.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, veprime shtesë nevojiten në menaxhimin e punës jashtë orarit si dhe raportimin e plotë të obligimeve të papaguara në MF.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për KGJK-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**21,288,771**	**19,122,245**	**18,791,104**	**18,293,129**	**16,760,413**
Granti i Qeverisë -Buxheti	20,074,871	17,827,080	17,643,133	16,844,640	15,555,444
Të hyrat vetjake	1,213,900	1,294,636	1,147,971	1,445,489	1,204,969
Donacionet	-	529	-	3,000	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është më i ultë për 2,166,525€. Ndryshimet buxhetore ishin rezultat i rishikimit të buxhetit, vendimeve të Ministrit të Financave si dhe vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2015, KGJK ka përdorur 98% të buxhet final ose 18,791,104€, me një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2014, në të cilin ishin shpenzuar 91%. Megjithatë, lidhur me realizimin e buxhetit jepen shpjegimet më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**21,288,771**	**19,122,245**	**18,791,104**	**18,293,129**	**16,760,413**
Pagat dhe Mëditjet	15,061,243	13,658,590	13,511,947	12,469,069	11,449,464
Mallrat dhe Shërbimet	3,711,599	3,725,340	3,601,422	3,717,614	3,472,471
Shërbimet komunale	515,929	419,594	419,042	464,704	436,544
Subvencionet dhe Transferet	250,000	439,423	380,288	279,589	266,374
Investimet Kapitale	1,750,000	879,298	878,404	1,362,153	1,135,560

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti për investime kapitale ishte reduktuar me rishikim të buxhetit për 820,000€ (rezultat i memorandumit të mirëkuptimit në mes KGJK-së dhe MAP-it për kalimin e dy projekteve për ndërtim në kuadër të MAP-it). Po ashtu me vendimin e Ministrit të Financave për kursime buxhetore buxheti në fund të vitit ishte reduktuar edhe për 50,702€;
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 1,402,653€. Fillimisht kishte rritje të buxhetit për 80,325€ nga të hyrat vetjake të vitit të kaluar, mirëpo më pas ishte reduktuar për 1,482,978€ (1,041,626€ me rishikim të buxhetit, 144,000€ me aprovim të Ministrit të Financave janë transferuar te mallrat dhe shërbimet, si dhe 297,352€ me vendim të Ministrit të Financave për kursime buxhetore). Reduktimi i buxhetit ishte rrjedhojë e mos inkorporimit të gjyqësorit të pjesës veriore në Sistemin e Gjyqësorit të Kosovës[1] dhe ndalimin e punësimeve të reja nga Ministria e Financave;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 13,741€. Fillimisht me rishikim të buxhetit, buxheti ishte reduktuar për 164,449€, mirëpo më pas si rezultat i transfereve ishte rritë për 191,500€ (144,000 € janë transferuar nga kategoria e pagave dhe mëditjeve dhe 47,500€ nga kategoria e komunalive). Ndërsa në fund të vitit, sipas vendimit të Ministrit të Financave për kursime buxhetore, buxheti ishte reduktuar për 13,839€;
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritë për 189,423€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishin ndarë mjete shtesë për 50,000€, ndërsa më pas me vendimin e Qeverisë janë ndarë edhe 139,423€; dhe
- Buxheti final për komunali ishte reduktuar për 96,335€. Prej tyre 47,500€ ishin transferuar te mallrat dhe shërbimet, ndërsa në fund të vitit me vendim të Ministrit të Financave për kursime buxhetore ishte reduktuar edhe për 48,835€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e KGJK-së – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	-	-	8,087,041	9,176,728	7014,519
Totali	**-**	**-**	**8,087,041**	**9,176,728**	**7014,519**

Të hyrat vetjake të realizuara gjatë vitit 2015 ishin 8,087,041€. Vlera prej 1,294,636€ sipas Ligjit të Buxhetit ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e KGJK-së, ndërsa pjesa e tjetër e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës.

Në raport me vitin paraprak vërehet një trend i rënies së të hyrave, si rezultat i zvogëlimit të hyrave nga gjobat në trafik. Lidhur me menaxhimin dhe raportimin e të hyrave ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

[1] Në marrëveshjen e Brukselit është paraparë që gjykatat në Veri të Kosovës të inkorporohen në Sistemin Gjyqësor të Kosovës, andaj është ndarë buxhet shtesë për këtë kategori.

Çështja 5 – Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate – Prioriteti i lartë

E gjetura Sipas Rregullës Financiare 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, neni 18, të gjitha blerjet duhet të regjistrohen në kode ekonomike adekuate.

KGJK ka planifikuar gabimisht një pjesë të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në kategorinë e investimeve kapitale. Nuk kishte përpjekje gjatë vitit për transferimin e tyre në kategorinë përkatëse. Andaj, blerjet e mallrave ishin procesuar dhe evidentuar në kategorinë e investimeve kapitale. Kjo është vërejtur te kontrata ''Furnizim me Pajisje të IT-së për KGJK-në'' në vlerë 157,589€, e cila për nga natyra i përket mallrave dhe shërbimeve, mirëpo ishte planifikuar, realizuar dhe raportuar në kategorinë e investimeve kapitale.

Rreziku Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate krijon paqartësi në raportimin e shpenzimeve të ndodhura. Kjo rezulton me mbivlerësimin e shpenzimeve në një kategori kundrejt nënvlerësimit në një kategori tjetër.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë që me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje të siguroj që të gjitha shpenzimet janë regjistruar në kategorinë ekonomike përkatëse.

3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Realizimi i projekteve kapitale të parapara për vitin 2015 është në përputhje me planin e prokurimit dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve. Të gjitha projektet kapitale ishin të koduara në sistemin për Programin e Investimeve Publike.

Bazuar në testet tona konkludojmë se realizimi i procedurave të prokurimit ishte në përputhje me rregullat e përcaktuara për prokurimin publik. Megjithëse, ne kemi identifikuar disa mangësi rreth administrimit të procesimit të pagesave, përfshirë zotimin, urdhërblerjen dhe vonesat në realizimin e pagesave.

Çështja 6 – Zotimi i mjeteve pas pranimit të faturës – Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet zotimi, pastaj të pranohet malli apo shërbimi dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë.

KGJK nuk kishte ndjekur procedurën e lartcekur. Në 19 lënde të testuara vërejtëm se zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturës. Në vijim kemi shpalosur pesë lënde me vlera më të mëdha:

- Në tri pagesa (fatura në vlerë 6,859€, fatura 11,376€ dhe fatura 30,124€) lidhur me kontratën "Shpenzimet postare", zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturës me vonesë nga 7 deri në 35 ditë;
- Te pagesa ''Renovimi i Objektit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë'' në vlerë 34,567€, zotimi mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturës me vonesë 26 ditë; dhe
- Te pagesa "Ndërtimi i Objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj " në vlerë 97,125€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të faturës me vonesë një ditë.

Ne kemi kërkuar nga zyrtarët përgjegjës të KGJK-së nëse ka shkaqe që mund ta arsyetojnë këtë dukuri (pranimin e mallrave dhe shërbimeve para zotimit), mirëpo nuk kemi marrë ndonjë shpjegim prej tyre. Si rrjedhojë vijmë në përfundim se në KGJK nuk ka kontrolle efikase në këtë aspekt.

Rreziku

Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa në realizimin e pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për periudhat vijuese.

Rekomandimi 6

Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj rritjen e efikasitetit në funksionimin e kontrolleve të brendshme ekzistuese në mënyrë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme.

Çështja 7 - Procesimi i Urdhërblerjes pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të procesohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, si dhe fatura.

Në 13 pagesa të testuara vërejtëm se urdhërblerja është procesuar pas pranimit të faturës. Në vijim kemi shpalosur katër lëndë me vlera më të mëdha:

- Te pagesa "Ndërtimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj "me vlerë 56,432€, urdhërblerja ishte nxjerrë 24 ditë pas pranimit të faturës;
- Te pagesa" Ndërtimi i Objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj" me vlerë 74,948€, urdhërblerja ishte nxjerrë 11 ditë pas pranimit të faturës;
- Te pagesa "Furnizim me pajisje të IT-së për KGJK" me vlerë 163,371€, urdhërblerja ishte nxjerrë pesë ditë pas pranimit të faturës; dhe
- Te pagesa ''Renovimi i Objektit te Gjykatës Themelore në Mitrovicë'' në vlerë 34,567€, urdhërblerja ishte nxjerrë dy ditë pas pranimit të faturës.

Zyrtarët e financave, gjatë procesimit të lëndëve për pagesë, kanë dështuar të ndjekin të gjithë hapat e përcaktuara me rregulla të thesarit. Në anën tjetër zyrtaret çertifikues nuk kanë arritur të parandalojnë këtë dukuri.

Rreziku

Pranimi i faturës para nxjerrjes së urdhërblerjes rritë rrezikun që të pranohen dhe të paguhen mallra dhe shërbime/investime kapitale jashtë cilësisë dhe sasisë së nevojshme.

Rekomandimi 7

Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

Çështja 8 – Vonesa në ekzekutimin e pagesave – Prioritet i mesëm

E gjetura KGJK nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor 30 ditë pas pranimit të faturës. Vonesat ishin vërejtur në 10 lëndë të testuara, mirëpo për qëllime të raportimit ne po i shpalosim pesë të tilla, si:

- Pagesa në vlerë 500€, lidhur me kontratën "Shërbimet e Përfaqësimit për Avokat "ishte realizuar me shtatë ditë vonesë;
- Pagesa në vlerë 2,564€, lidhur me kontratën "Furnizim me karburante për ngrohje" ishte realizuar me 21 ditë vonesë;
- Pagesa në vlerë 11,376€, lidhur me "Shpenzimet Postare" ishte realizuar me 68 ditë vonesë;
- Pagesa në vlerë 8,995€, për ''Kompensimin e Dëmit të Personave të Dënuar pa Bazë'' ishte realizuar me 173 ditë vonesë; dhe
- Pagesa në vlerë 17,147€ "Kompensimin e Dëmit të Personave të Dënuar pa Bazë''' kompensimi ishte realizuar 205 ditë me vonesë.

Rreziku Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë për dëmshpërblimet ndaj OE-së dhe përfituesve të kompensimit të dëmit. Gjithashtu, mund të rrezikojnë në dështimin e pagesave në mungesë të fondeve dhe bartjen e obligimeve në vitin pasues.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i KGJK-së në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të sigurojnë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Komunalitë, shpenzimet e rrymës

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam disa pagesa të cilat përfshijnë shpenzimet e rrymës, avanset për udhëtime zyrtare, shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e përfaqësimit të avokaturës. Bazuar në këtë ne nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për ta theksuar në këtë raport.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollet që operojnë në nivel të KGJK-së kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Shpenzimet e realizuara për paga dhe mëditje gjatë vitit 2015 ishin 13,511,947€, me rreth 1,817 punonjës. Fokusi ynë gjatë auditimit ka qenë kryesisht te dosjet e personelit, rregullsia në procesimin e pagave, respektimin e afateve ligjore, etj.

Bazuar në ketë ne identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 9 – Realizimi i punës jashtë orarit pa aprovim, si dhe tejkalime të normës së lejuar - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas UA 2014/2[2], kompensimet për punë jashtë orarit mund të realizohet vetëm nëse ka pasur kërkesë paraprake nga eprori i drejtpërdrejt dhe lejimi nga udhëheqësi i administratës së paku një ditë më herët.

Në gjashtë raste vërejtëm se kompensimi për punë jashtë orarit është bërë pa kërkesë me shkrim, respektivisht pa aprovim paraprak të mbikëqyrësit. Kjo ishte si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve për të siguruar menaxhimin e kompensimeve në pajtim me legjislacionin përkatës.

E gjetura Sipas Ligjit për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 , neni 38 në raste të veçanta dhe për shkak të rritjes së nivelit të punës, të cilat kërkojnë punë shtesë, institucioni punëdhënës kërkon nga punonjësit që të punojnë jashtë orarit. Shuma totale e orëve jashtë orarit të punës nuk mund të tejkalojë katër (4) orë në ditë dhe në asnjë rast më shumë se njëzet (20) orë në javë dhe dyzet (40) orë në muaj.

Gjatë testimit të lëndëve për kompensimin e shtesave për punë jashtë orarit të punës në shtatë raste është vërejtur se shuma totale e orëve të punës jashtë orarit për muaj ishte tejkaluar për 101 orë punë[3]. Tejkalimet ishin kryesisht te stafi që bënë sigurimin e objektit. Në rastet kur një pjesë e stafit të sigurimit ishte në pushime vjetore, mjekësore etj, stafi tjetër kishte kompensuar orarin e punës.

Rreziku Kompensimi për punë jashtë orarit pa aprovim nga personat e autorizuar paraqesin pagesa të parregullta. Ndërsa kompensimi për punë jashtë orarit mbi normën e lejuar anashkalon rregullat e shërbimit civil, shkakton mbingarkesa në punë, si dhe rrezikon cilësinë dhe rezultatet e punës.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i KGJK-së duhet të siguroj se menaxhimi i kompensimeve për punë jashtë orarit, bëhet në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Në rastet kur kërkohet nevoja për punë jashtë orarit, duhet të paraqitet dhe të aprovohet kërkesa nga nivelet përgjegjëse. Më tej të sigurohet se orët e realizuara për punë jashtë orarit nuk tejkalojnë limitet e përcaktuara.

[2] UA 2014/2, Procedura për realizimin e shtesave mbi pagën dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil , neni 10.2 dhe 10.4

[3] Shuma totale e lejuar mbi orarin e rregullt është 40 orë pune (7 të punësuar X 40 orë= 280orë). Shtatë të punësuarit kishin realizuar 381 orë pune jashtë orarit, ose 101 orë punë mbi orët e lejuara.

3.5.3 Subvencione dhe Transfere

Kategoria e subvencioneve dhe transfereve shfrytëzohet kryesisht për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye. Lidhur më këtë KGJK ka vendosur kritere dhe procedura të qarta për kompensimin e dëmeve.

Shpenzimet e realizuara për subvencione dhe transfere për vitin 2015 ishte 380,288€.

Gjatë testimit në këtë kategori nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për të raportuar, me përjashtim të vonesave në kompensimin e dëmeve për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye. Kjo çështje është raportuar në kapitullin 3.4. Prokurimi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Të hyrat e realizuara nga KGJK në 2015 ishin në vlerë 8,087,041€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga taksat gjyqësore, të hyrat nga gjobat e trafikut, të hyrat nga gjobat e Gjykatave.

Përveç të hyrave, KGJK menaxhon edhe një fond të parave nga depozita e gjykatave të cilat njihen si llogari e mirëbesimit. Në fund të vitit llogaria e mirëbesimit ishte 2,733,171€. Prej tyre 788,409€ ishin depozitat e realizuara në vitin 2015, ndërsa pjesa tjetër ishte saldoja nga vitet paraprake.

Ne kemi testuar nëse ka evidenca të mjaftueshme për të hyrat e realizuara, si dhe nëse janë bërë harmonizimet e duhura në mes të raporteve të gjykatave, raportit të brendshëm të KGJK-së dhe atij të Bankës Qendrore të Kosovës.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të azhurnuara në përputhje me pasuritë e reja dhe ndryshimet e tjera.

Pasuritë neto me vlerë mbi 1,000€ të KGJK-së ishin 15,620,860€, ndërsa pasuritë me vlerë nën 1,000€ ishin 977,244€. Të dhënat e prezantuara në PVF për pasuritë nën 1,000€ janë marr nga raporti i inventarizimit të pasurisë për vitin 2015.

Çështja 10 – Dobësi në evidentimin e pasurisë nën vlerën 1,000€ – Prioritet i lartë

E gjetura

KGJK nuk kishte evidenca për menaxhimin e pasurisë me vlerë nën 1,000€, përkatësisht nuk ishte përdorë sistemi e-pasuria ose ndonjë bazë tjetër e të dhënave për evidentimin e tyre. Në mungesë të tyre, për qëllime të raportimit të pasurisë në PVF, KGJK kishte shfrytëzuar vetëm raportet e inventarizimit që kryhen në fund të çdo viti nga komisionet e inventarizimit të pasurisë.

Inventarizimi i pasurisë është kryer për vitin 2015 në kuadër të KGJK-së, mirëpo nuk ka qenë i kompletuar për të gjitha njësitë. Gjykata Themelore në Prishtinë nuk e kishte kryer inventarizimin me kohë, andaj raporti përmbledhës i inventarizimit nuk ishte i kompletuar. Si rezultat i kësaj pasuritë jo-financiare të prezantuara në PVF ishin të nënvlerësuara për 181,389€.

Rreziku

Informatat financiare ekzistuese mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Kjo pamundëson një menaxhim efektiv dhe kontroll mbi pasuritë.

Rekomandimi 10

Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që sistemi e-pasuria të futet sa më shpejtë në përdorim. Në rast nevoje zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 393,112€.

Në fazën e ndërmjetme të auditimit ne kemi identifikuar se obligimet e papaguara nuk ishin raportuar në MF për pesë muajt e parë të vitit 2015. Mirëpo nga qershori i vitit 2015, obligimet e papaguara ishin raportuar rregullisht. Mirëpo edhe përkundër kësaj raportet e dorëzuara në MF nuk ishin të plota. Bazuar në këtë ne identifikuam çështjen si në vijim:

Çështja 11 – Raportim jo i saktë i obligimeve të papaguara –Prioritet i mesëm

E gjetura

Sipas Rregullës financiare nr. 02/2013/MF, Raportimi i obligimeve të papaguara citon: "Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave - Thesar të raportojnë obligimet e tyre të papaguara. Raportimi, sipas kësaj rregulle financiare, bëhet përmes raporteve mujore".

KGJK, nuk kishin kontrolle të mjaftueshme në raportimin e obligimeve. Në tri pagesa të testuara vërejtëm se ato nuk ishin raportuar si obligime të papaguara, si:

- Fatura në vlerë 11,377€, e pranuar me datë 18 maj 2015, e pa paguar deri me 25 gusht 2015, nuk ishte shpalosur si obligim në raportet e obligimeve të papaguara të muajve qershor dhe korrik;
- Fatura në vlerë 2,727€, e pranuar me datë 30 tetor 2015, e papaguar deri me 06 nëntor 2015, nuk ishte shpalosur si obligim në raportet e obligimeve të papaguara për muajin tetor; dhe
- Fatura në vlerë 407€, e pranuar me datë 24 dhjetor 2015, e papaguar deri me 15 janar 2016, nuk ishte shpalosur si obligim në raportet e obligimeve të papaguara për muajin dhjetor.

Rreziku

Raportimi jo i saktë i obligimeve të papaguara rritë rrezikun për ekzekutimin e pagesave të dyfishta ose në mos pagesë të obligimeve ndaj kontraktuesve si dhe anashkalon rregullat e MF-së për raportimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimi 11

Kryesuesi i KGJK-së duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të identifikuar shkaqet e mos raportimit të drejt të obligimeve të papaguara, dhe të sigurojë se raportimi i tyre bëhet në përputhje me kërkesat. Të gjitha faturat e papaguara duhet të përfshihen në raportin mujor të obligimeve dhe vlera e tyre duhet të përcjellët deri në pagesën e tyre.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditivit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçë për të cilat KGJK duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë se plani i veprimit përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve të AP-së, me fokus fillestar në fushat e rëndësisë më të madhe. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga menaxhmenti në baza të rregullta kohore.		Nga shtatë rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit për PVF-të e vitit 2014, një rekomandim ishte implementuar, tri janë adresuar pjesërisht, ndërsa tri nuk ishin adresuar.	
4.2 Planifikimi dhe realizimi buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se me rastin e planifikimit të buxhetit, janë bërë analiza të hollësishme dhe janë identifikuar nevojat reale të shpenzimeve, përfshirë edhe kategorizimin e tyre. Më tutje, të siguroj se të gjitha shpenzimet janë regjistruar në kategoritë ekonomike adekuate.			Nuk janë marrë masa. Edhe në vitin 2015 janë vërejtur pagesa që nuk janë klasifikuar në kategoritë adekuate.
4.4.1 Prokurimi	Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP -në, dhe me rregullat e Thesarit.			Nuk janë marrë masa. Edhe në vitin 2015 kishte dobësi në ekzekutimin e pagesave.
4.4.1 Prokurimi	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk janë marrë masa. Edhe në vitin 2015 kishte vonesa në realizimin e pagesave.

4.4.3 Pagat dhe Mëditjet	Drejtori i përgjithshëm duhet të monitorojë kontrollet në menaxhimin e personelit për të siguruar se periudha e angazhimit të zyrtarëve si UD të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ.	Është Implementuar.		
4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i përgjithshëm në bashkëpunim me zyrtaret përgjegjës duhet të përcaktoj arsyet e mos regjistrimit të plotë të pasurisë dhe të sigurojë se regjistrat e pasurisë janë të azhurnuara rregullisht me informatat e nevojshme.		KGJK ka marrë masa dhe ka evidentuar pasuritë me vlerë mbi 1,000€ në regjistrin kontabël, mirëpo edhe më tutje nuk kishin evidenca të plota lidhur me pasuritë me vlerë nën 1,000€.	
4.5.2 Obligimet e papaguara	Drejtori i përgjithshëm duhet që të ndërmerr masa të nevojshme për të identifikuar shkaqet e mos raportimit të drejtë të obligimeve të papaguara, dhe të sigurojë se vlera e saktë e obligimeve përcjellët nga muaji në muajin vijues në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.		KGJK nga qershori 2015 ka filluar me raportimin e obligimeve të papaguara, mirëpo raportet e obligimeve nuk ishin të plota dhe të sakta.	